

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-137/15

Prishtinë,
28 Shkurt 2018

Në çështjen juridike të

K. e K.

Pala ankuese

kundër

C. L.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur rreth ankesës kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/R/245/2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA51220) të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 28 Shkurt 2018 mori këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e K. së K. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/245/2014 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA51220) të datës 18 qershor 2014, hidhet poshtë si e papranueshme për shkak se pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 12 nëntor 2007, C. L. (më tej: pala përgjegjëse në ankesë) duke vepruar si pasardhëse e bashkëshortit të saj të ndjerë – bartësi i pretenduar i të drejtës pronësore P. L., ka paraqitur një kërkesë në AKP duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin e një banesë me sipërfaqe prej 46.74 m², që ndodhet në Klinë, rruga ~~“V. Andrejevića”~~ (më tej: prona e kërkuar). Pala përgjegjëse në ankesë deklaroi P.L. ka qenë pronar i pronës së kërkuar dhe ai e kishte humbur posedimin mbi të më 12 qershor 1999 si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, pala përgjegjëse në ankesë dorëzoi në AKP:
 - Kopjen e Certifikatës së Martesës Nr. 200/343 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Klinës më 18 mars 1993 që vërteton se pala përgjegjëse në ankesë dhe bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore janë martuar më 16 shkurt 1970.
 - Vendimin për Ndarje nr.102 të lëshuar më 16 mars 1993 nga Spitali Special për trajtimin e Tuberkulozit dhe sëmundjeve tjera të mushkërive, me të cilin një banesë me dy dhoma në ndërtesën ATD Klinë, rruga ~~“V. Andrejevića”~~ i ishte ndarë për shfrytëzim bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore P. .. Neni 2 i Vendimit për Ndarje specifikon se P.L. obligohet të lidh Kontratë për shfrytëzim të banesës me Ndërmarrjen Banesore.
 - Kontratën e blerjes të lidhur në Pejë më 31 mars 1993 me të cilin bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore P. L. e ka blerë pronën e kërkuar nga Spitali Special për trajtimin e Tuberkulozit dhe sëmundjeve tjera të mushkërive. Kontrata është verifikuar dhe vërtetuar nga Gjykata Komunale në Klinë më 5 prill 1993 me numrin 391/1993.
 - Kopjen e Certifikatës së Vdekjes nr.3 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës Andrejevića më 2 qershor 2004 që vërteton se bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore P. L. kishte vdekur më 27 maj 2004.
3. Më 19 nëntor 2008 dhe më pas më 26 dhjetor 2012, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e bëri njoftimin e kërkesës. Banesa u gjet e uzurpuar nga Departamenti i Zjarrfikësve të Klinës (më tej: pala ankuese).

- Shefi i brigadës së Zjarrfikësve E. Z. deklaroi se Komuna kishte vendosur t'ia ndante banesën brigadës së Zjarrfikësve pas renovimit, por ai refuzoi që ta nënshkruante Njoftimin për Pjesëmarrje.
4. Të gjitha dokumentet e prezantuara nga pala përgjegjëse në ankesë janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së.
 5. Më 18 qershor 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/R/245/2014 vendosi se pala përgjegjëse në ankesë kishte vërtetuar se P. L. ishte pronari i pronës së kërkuar dhe se pala përgjegjëse në ankesë kishte të drejtën e posedimit të pronës në fjalë.
 6. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 31 tetor 2014. Ankesa u paraqit më 14 nëntor 2014 nga Ali Shala.

Pretendimet e palës ankuese:

7. Pala ankuese pretendon se Vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, dhe bazohet në vërtetim të gabueshëm apo të mangët të gjendjes faktike.
8. Pala ankuese pretendon se toka në të cilën është ndërtuar prona e kërkuar është shpronësuar nga K.e K. nga pronari i mëparshëm Gj. M. P. në vitin 1964. Qëllimi i shpronësimit ka qenë ndërtimi i objekteve të Departamentit të Zjarrfikësve. Pronarit të mëparshëm i është dhënë tokë për kompensim.
9. Ndër tjera, pala ankuese ka shprehur pretendime tjera:
 - AKP-ja nuk e ka informuar si duhet dhe me kohë Komunën rreth rastit në fjalë dhe Komunës nuk i është dhënë mundësia që t'i bëjë deklaratat dhe qartësimet e veta si dhe t'i paraqes provat e veta.
 - Para se pala përgjegjëse në ankesë ta fitojë ndonjë të drejtë eventuale të privatizimit të pronës së kërkuar, duhet të procedohet e Drejta valide e shfrytëzimit nga personi juridik që në këtë rast është Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit (BVI).
 - Rasti lëndor nuk bie nën kompetencën e AKP-së për shkak të faktit vendimtar dhe notor se pala përgjegjëse në ankesë, as para konfliktit e as pas, nuk ka pasur posedim të vlefshëm të pronës lëndore të banimit dhe nuk ka pasur mundësi që ta humb atë.
 - Kontrata e Shitblerjes nr.132, e lidhur më 31 mars 1993, nuk është e vlefshme.
 - Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka gëzuar të drejtën e posedimit ligjor të pronës së kërkuar sipas nenit 71 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr.6/80) në lidhje me nenin 29 të njëjtit ligj për faktin se pala përgjegjëse në ankesë nuk ka qenë fare punëtore e spitalit.

10. Për ta mbështetur ankesën e tij, pala ankuese dorëzoi në Gjykatën Supreme dokumente që nuk kanë të bëjnë me pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa është e papranueshme sepse është paraqitur nga një person që nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë para KKPK-së.
12. Në përputhje me nenin 12.1 të Ligjit nr.03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës rreth Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.
13. Neni 10.1 i Ligjit nr.03/L-079 parasheh se pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive njofton dhe dërgon një kopje të kërkesës çdo personi përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës.
- Neni 10.2 i ligjit të njëjtë parasheh se *“Çdo person përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo mëton se ka të drejta mbi pronën që është objekt i kërkesës dhe/ose ndonjë person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë ... , me kusht që ai person e informon Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij/saj që të merr pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e njoftimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive [...]”*.
14. Vetëm pala në procedurë në shkallën e parë ka të drejtë që të paraqet ankesë kundër Vendimit të KKPK-së. Bazuar në praktikën e Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme, përjashtimi i vetëm ndaj këtij rregulli paraqitet nëse personi i cili mund të kërkojë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka pasur njohuri se kërkesa ishte paraqitur në AKP për shkak të njoftimit të gabueshëm dhe prandaj ai/ajo nuk është në gjendje ta paraqet njoftimin e pjesëmarrjes gjatë procedurës në shkallën e parë.
15. Në rastin në fjalë, Gjykata Supreme është e mendimit se pala ankuese ka qenë në dijeni për procedurën në lëndën KPA51220, ngase departamenti i Zjarrfikësve në Klinikë funksionon nën ombrellën e Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencat të Komunës së Klinikës. Prona e kërkuar ishte njoftuar tri herë dhe ishte gjetur e uzurpuar nga Departamenti i Zjarrfikësve të Komunës së Klinikës. Shefi i departamentit, E.Z. deklaroi se pronat e kërkuar iu ishin dhënë atyre për shfrytëzim nga K. e K. pas renovimit të ndërtesës, por refuzoi që ta nënshkruajë Njoftimin e Pjesëmarrjes para AKP-së si dhe nuk paraqiti ndonjë dokument për ta mbështetur pretendimin e tij.

16. Gjykata Supreme vëren se në bazë të fakteve të lartcekura, pala ankuese i ka pasur të gjitha mundësitë që të jetë në dijeni për procedurën që po zhvillohej në shkallën e parë, duke pasur parasysh se njoftimi ishte kryer si duhet duke i vendosur shenjat përkatëse te ngastra e cekur.
17. Ankesa duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 12.1 dhe 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1, nën-paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Prandaj, Kolegji i Apelit të AKP-së vendosi sikurse në dispozitiv.
18. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese që ta kërkojë të drejtën e saj para gjykatës kompetente nëse e konsideron të domosdoshme.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr.03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani, Gjyqtar

Timo Eljas Torkko, Referent i EULEX-it